



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1212 prot.
2023

Tiranë, më 30. 10.

V E N D I M

Nr. 220, datë 30. 10. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 194 regj, datë 28.09.2023, të paraqitur nga Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Dega Durrës², kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimit Social Shtetëror³ dhe strukturave të ngritura prej tyre, me pretendimin diskriminimin për shkak të “aftësisë së kufizuar”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Dega Durrës, në emër të anëtarëve të saj shpreh shqetësimin mbi problematikat e shkaktuara nga komisionet e rivlerësimit online dhe autoriteti i Task-Forcës, të ngritur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe strukturat në varësi të tyre.

Sipas Shoqatës: “...mbivendosja e komisioneve absurde dhe përplasja e vendimeve KEMP Epror (që komisionon fizikisht) me instanca të ngritura enkas me qëllime, gjoja pozitive, (komisione online, taks-forcë etj., që shohin veç nga ekrani i telefonit), por që po rezultojnë diskriminuese, është shkak i gjithë këtyre penalizimeve ndaj personave Para & Tetraplegjikë me: heqje të

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin Shoqata.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën SHSSH.

paketës higjieno-sanitare, spostim grupimi (divergjencë), ekzaminime të panevojshme të përvitshme edhe kur personi është në gjendje tetraplegjike (i shtrirë) për diagnoza të rënda dhe të parikuperueshme, komisionime të përvitshme, kur në të gjithë Shqipërinë nuk ka një Qendër Rehabilitimi, etj.

Komisionimi online, ka sjell gjithë këto problematika për personat paraplegjikë apo tetraplegjikë, të cilët janë të detyruar nga penalizimet dhe kanë bërë ankesë përsëri në KEMP-in Epror për rikomisionim (të ripërsëritur), madje dhe nga ata që janë transportuar dhe me barrelë në komision.

Po ashtu kujdestari/a i një personi paraplegjik-tetraplegjik, trajtohet me pagesë 12.500 lek/muaj, ndërkohë që qeveria paguan sigurime-shoqërore aq sa për pagë/mujore (minimale)”.

Përfundimisht Shoqata kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar dhe marrjen e masave për:

“1. Trajtimin e personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, sipas Ligjit Nr. 8626, datë 22.06. 2000 dhe VKM-së nr. 31, datë 20.01.2001, së ndryshuar me Vendim nr. 302, datë 27.06.2002, ku sipas pikës 1, germa “a” parashikohet se: “të sëmurët tetraplegjikë që kanë humbur mbi 55 përqind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestare” dhe germa “b”: “të sëmurët paraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 përqind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer, e që kanë nevojë për kujdestarë”. Pra, përfshirja e gjithë diagnozave të rënda që janë gjendje paraplegjike e tetraplegjike.

2. Çdo person që përfiton statusin Paraplegjik & Tetraplegjik, (pavarësisht ndjeshmërisë dhe moshës) të trajtohet me paketë higjieno-sanitare, për mungesë të aftësisë për vetëshërbim.

3. Të ndalohen sorollatjet “shkatërruese” me ekzaminime të tepërta, (skaner, grafi, EZHE) të përvitshme, për personat paraplegjikë-tetraplegjikë me diagnoza të parikuperueshme.

4. Trajtimi i kujdestarit për personat paraplegjikë - tetraplegjikë, (veçanërisht, tetraplegjikët që kanë nevojë 24 orë për shërbim dhe përkuqjesje) të jetë minimumi, sa paga minimale e një punonjësi buxhetor, bashkë me të gjitha benefitet që ka një punonjës buxhetor, (pasi ata trajtohen me pagesë 12.500 lek/muaj, ndërkohë që qeveria paguan sigurime shoqërore).

5. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët që jetojnë vetëm, (dhe pa të afërm familjar) të trajtohen me kujdes të veçantë, pasi askush nuk iu shërben, qoftë dhe me pagën minimale”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutuar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfutim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;...”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Më datë 09.10.2023, përmes e-mail-it, Komisioneri iu drejtua subjektit ankues, duke kërkuar plotësimin e saj nga ana formale duke vënë në dispozicion sqarime, prova dhe fakte sa i përket saktësimin të subjekteve ndaj të cilëve ankohet, si dhe informacione shtesë sa i përket situatës diskriminuese të pretenduar.

Më datë 23.10.2023, përmes e-mail-it, Shoqata paraqiti një kërkesë me shkrim, nëpërmjet të cilës deklaroi se heq dorë dhe tërhiqet nga ankesa nr. 194, datë 28.09.2023, objekt shqyrtimi.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”. Ndërsa, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1, e Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërhequr atë”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga pala ankuese në datën 23.10.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës nr. 194 regj, datë 28.09.2023, të paraqitur nga Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Dega Durrës, kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimit Social Shtetëror dhe institucioneve të ngritura prej tyre, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 94, pika 1, e Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarohet të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 194 Regjistri, datë 28.09.2023, paraqitur nga Shoqata e Invalidëve

Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Dega Durrës, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)